



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR

**LICENCIMIN E SHOQËRISË KOMISIONERE, REGJISTRIMIN E DEGËS SË
SHOQËRISË SË HUAJ KOMISIONERE DHE NJOHJEN E SHOQËRISË SË HUAJ
KOMISIONERE**

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 195, datë 29.12.2020
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 127, datë 28.07.2021

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i rregullores

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i formës së kërkesës, paketës së dokumentacionit të nevojshëm, procedurës dhe afateve për:
 - a) Licencimin e shoqërisë komisionere;
 - b) Licencimin e bankës, së licencuar nga Banka e Shqipërisë, për ofrimin e shërbimeve të investimit në tituj;
 - c) Zgjerimin e veprimtarisë së shoqërisë komisionere;
 - d) Regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere për ofrimin e shërbimeve të investimit në tituj në Republikën e Shqipërisë;
 - e) Njohjen e shoqërisë së huaj komisionere për ofrimin e shërbimeve të investimit në tituj në Republikën e Shqipërisë;
 - f) Miratimin e ndryshimit të pjesëmarrjes influencuese, administratorit apo anëtarit të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe funksionarit kryesor.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, nenit 14, pika 3 dhe 4, nenit 16, pika 2, nenit 27, pika 3, nenit 35, pika 6, nenit 39, pika 2, nenit 45 pika 2 të Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”.

Neni 3

Përkufizimet

Në këtë rregullore:

1. “Personel kyç” është punonjësi i bankës që kryen funksionin e brokerit, këshilltarit të investimeve, administratorit të portofolit apo që ofron shërbime të tjera investimi për klientin në përputhje me veprimtaritë për të cilat është licencuar banka.
2. “Funksionar kryesor” është personi fizik/individ, që ushtron funksione drejtuese në një shoqëri komisionere, si më poshtë:
 - a) Drejtori i Departamentit të Financës;
 - b) Drejtori i Departamentit të Përputhshmërisë;
 - c) Drejtori i Departamentit të Parandalimit të Pastrimit të Parave;
 - d) Drejtori i Departamentit të Administrimit të Rrezikut;
 - e) Drejtori i Departamentit të Auditimit të Brendshëm.
3. “Bankë” është Banka dhe dega e bankës së huaj e licencuar nga Banka e Shqipërisë.
4. “Veprimtari tregtare” përfshin shërbimet e investimit dhe shërbimet ndihmëse.
5. “Shërbim investimi online” është ofrimi i shërbimit të investimit në distancë nga shoqëria komisionere/banka nëpërmjet një rrjeti elektronik komunikimi.
6. Të gjitha përkufizimet e tjera të kësaj rregulloreje janë të njëjta me ato të Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” të referuar në këtë rregullore si “Ligji”.

Neni 4

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për:

1. Shoqërinë komisionere, e themeluar si shoqëri aksionare sipas legjislacionit në fuqi, me selinë Republikën e Shqipërisë.
2. Bankën, e licencuar nga Banka e Shqipërisë, për kryerjen e veprimtarive financiare të përcaktuara në nenin 54 të Ligjit për Bankat.
3. Shoqërinë e huaj komisionere që ofron shërbime investimi në tituj në Republikën e Shqipërisë.

Neni 5

Kërkesa mbi dokumentacionin për licencim

1. Dokumentacioni i kërkuar sipas kësaj rregulloreje duhet të jetë në gjuhën shqipe, original ose kopje e noterizuar.
2. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga një autoritet i huaj rregullator, dokumentacioni duhet të legalizohet në njërin nga mënyrat e mëposhtme:
 - a. Konfirmim nga autoriteti i huaj rregullator siç përcaktohet në legjislacionin e atij vendi;
 - b. Përputhje me përcaktimet në aktet ligjore përkatëse të së drejtës ndërkombëtare në këtë fushë, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.
3. Dokumentacioni që merret me kërkesë të personit, duhet të jetë lëshuar jo më parë se 3 (tre) muaj nga dorëzimi i kërkesës për licencim, regjistrim apo njohje.
4. Subjekti kërkues i licencës është përgjegjës për vërtetësinë dhe saktësinë e dokumentacionit të dorëzuar në Autoritet.

KREU II

LICENCIMI I SHOQËRISË KOMISIONERE

Neni 6

Formë-kërkesa

1. Çdo subjekt mund të kërkojë të licencohet për kryerjen e një ose më shumë veprimtarive të rregulluara sipas këtij ligji, duke specifikuar edhe shërbimet ndihmëse.
2. Subjekti kërkues nuk mund të licencohet vetëm për ofrimin e shërbimeve ndihmëse.

3. Kërkesa për licencim si shoqëri komisionere bëhet sipas shtojcës 1 të kësaj rregulloreje shoqëruar nga dokumentacioni i kërkuar.
4. Formë-kërkesa plotësohet dhe nënshkruhet nga përfaqësuesi/t ligjor/ë të shoqërisë komisionere dhe çdo individ që kërkohet sipas seksioneve përkatëse.
5. Shtojca 1 plotësohet në format elektronik dhe dorëzohet e printuar në format A4 në të gjitha rubrikat e saj, në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe pa korrigjime.

Neni 7

Dokumentacioni mbi krijimin dhe organizimin e subjektit kërkues për licencë

Dokumentacioni mbi krijimin dhe organizimin e subjektit përmban si mëposhtë:

1. Ekstraktin e regjistrimit në QKB të subjektit kërkues.
2. Statutin, ku objekti i veprimtarisë dhe kapitali minimal fillestar, të përputhet me veprimtarinë për të cilat subjekti kërkon të licencohet si dhe të përshkruhet roli i anëtarëve të pavarur të këshillit të administrimit, shoqëruar me një përshkrim të detyrave dhe përgjegjësive të tyre.
3. Lista e shërbimeve dhe aktiviteteve të investimit që synohen të kryhen, përfshirë shërbimet ndihmëse dhe instrumentet financiarë që mund të ofrohen.
4. Strukturën organizative/organigramën e shoqërisë, me përshkrimin mbi funksionet dhe përgjegjësitë e funksionarëve kryesorë.
5. Kontratë pune me administratorin.
6. Dokumentin që vërteton certifikimin për aftësi dhe përshtatshmëritë funksionarëve kryesorë dhe dokumentacionin mbështetës.
7. Deklaratën e përgjegjësisë, ku të përshkruhen përgjegjësitë e funksionarit kryesor si dhe përshkrimin e funksioneve dhe përgjegjësive kryesore nëse një funksionar kryesor do të ushtrojë më shumë se një funksion.
8. Vërtetimin bankar që konfirmon pagesën në para, për llogari të shoqërisë, të kapitalit minimal fillestar në përputhje me nenin 17 të Ligjit, i cili duhet të mbahet i bllokuar në favor të Autoritetit, në një nga Bankat në Republikën e Shqipërisë. Kjo shumë zhblokohet nëpërmjet njoftimit të Autoritetit, në përfundim të procedurës së licencimit.

9. Nëse shoqëria ka ushtruar një aktivitet tjetër përpara kërkesës për të vepruar si shoqëri komisionere, përveç dokumenteve të mësipërme, duhet të depozitojë:
 - a. Pasqyrat financiare të audituara për 3 vitet e fundit, dhe në rastin e një shoqërie më të re pasqyrat që nga krijimi;
 - b. Vërtetim nga administrata tatimore mbi gjendjen e detyrimeve tatimore;
 - c. Deklaratë se shoqëria nuk është nën hetim dhe/ose proces gjyqësor për kryerjen e ndonjë vepre penale.

Neni 8

Dokumentacioni mbi aksionarët dhe burimin e kapitalit

Dokumentacioni mbi aksionarët dhe burimin e kapitalit përmban si më poshtë:

1. Strukturën aksionare të kapitalit të shoqërisë.
2. Për aksionarët me pjesëmarrje influencuese në shoqërinë kërkuese, një përmbledhje e veprimtarisë/aktivitetit të tyre.
3. Të dhëna për shoqëri të tjera, ku aksionari me pjesëmarrje influencuese në shoqërinë komisionere, është aksionar/ortak kryesor ose ushtron kontroll.
4. Strukturën dhe listën e aksionarëve përfitues fundorë të shoqërisë kërkuese.
5. Të dhëna për integritetin dhe burimin e kapitalit.
 - I. Kur aksionari është person juridik, shoqëria kërkuese duhet të depozitojë:
 - a) Ekstraktin e regjistrimit në QKB;
 - b) Pasqyrat financiare të audituara për 3 vitet e fundit, dhe në rastin e një shoqërie më të re pasqyrat që nga krijimi;
 - c) Dokument të lëshuar nga administrata tatimore mbi gjendjen e detyrimeve tatimore;
 - d) Vërtetim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë për gjendjen e kredive në sistemin bankar;
 - e) Deklaratë se shoqëria nuk është nën hetim dhe/ose proces gjyqësor për kryerjen e ndonjë vepre penale;
 - f) Dokument se shoqëria nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera.
 - II. Kur aksionari është individ, shoqëria kërkuese duhet të depozitojë:
 - a) Dokument identifikimi (ID/ pasaporte);

- b) Curriculum vitae;
- c) Diploma, kualifikime, trajnime;
- d) Dëshmi të burimeve të krijimit të kapitalit si blerje ose shitje, dhurata, paga, depozita monetare në banka dhe/ose degë të bankave të huaja, apo dëshmi të tjera për burimin e krijimit të kapitalit;
- e) Dokument të lëshuar nga administrata tatimore mbi gjendjen e detyrimeve tatimore;
- f) Vërtetim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë për gjendjen e kredive në sistemin bankar;
- g) Dokumentacion të lëshuar nga organet kompetente si më poshtë:
 - i. Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
 - ii. Vërtetim nga prokuroria për hetim penal në proces;
 - iii. Vërtetim nga gjykata për çështje gjyqësore në proces;
 - iv. Dokument lidhur me procese ekzekutimi të detyrueshëm apo për detyrime pasurore të pashlyera;
 - v. Deklaratë personale për lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë sipas aneksit 3 të shtojcës.

6. Dokumentacioni i parashikuar në pikën 5 të këtij neni plotësohet edhe nga aksionarët e aksionarit person juridik me pjesëmarrje influencuese, që zotërojnë mbi 30% të aksioneve me të drejtë vote. Kjo kërkesë duhet të plotësohet nga shoqëria komisionere gjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së licencës.

Neni 9

Dokumentacioni mbi rregullat, procedurat dhe sistemet e subjektit kërkues

Dokumentacioni mbi rregullat, procedurat dhe sistemet përfshin si më poshtë:

1. Dokument ku parashikohet një përshkrim mbi sistemin e teknologjisë së informacionit, të kontabilitetit dhe të kontrollit, në pronësi apo në përdorim, për të dëshmuar se kanë dhe përdorin në mënyrë efikase burimet e procedurat e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë në mënyrën e duhur. Pjesë e këtij sistemi duhet të jetë edhe sistemi i regjistrimit të telefonatave dhe ruajtja e të dhënave të klientëve.
2. Planin e biznesit, minimumi për tre vitet e para të aktivitetit, përfshirë përshkrimin e veprimtarisë së subjektit, perspektivat e zhvillimit të veprimtarisë, pritshmëritë e subjektit mbi veprimtarinë që do të kryejë, mënyrën e përmbushjes së kërkesave për mjaftueshmëri kapitali.

Plani i biznesit përfshin edhe sa më poshtë:

- a) Planin e marketingut të shoqërisë, përfshirë klientët e synuar;
- b) Planin financiar, duke përfshirë një përshkrim se si do të mbulohet kostoja e fillimit të veprimtarisë dhe se si do të ruhen dhe zbatohen kërkesat e mjaftueshmërisë së kapitalit;
- c) Informacion mbi brokerin/këshilltarin e investimeve/administratorin e portofolit, të cilët janë certifikuar apo do të certifikohen nga shoqëria në përputhje me kërkesat e Ligjit dhe rregullores në fuqi;
- d) Programin për trajnimin e vazhdueshëm të të gjithë personelit për të përmbushur standardet për aftësitë profesionale, siç parashikohen në këtë Ligj dhe në rregulloret e miratuara në zbatim të tij;
- e) Informacionin e hollësishëm për procesin e administrimit të rrezikut. Shoqëria duhet të paraqesë informacion mbi natyrën e rreziqeve që lidhen me llojin e shërbimeve që do të ofrojë, mënyrën e identifikimit të tyre, matjes, menaxhimit dhe zbutjes, duke parashikuar treguesit që do të përdoren për nivelin e rrezikut që do të marrë përsipër, përfshirë emrat e personave përgjegjës për këtë funksion.

3. Manualet dhe procedurat:

- a) Procedura dhe kontrole lidhur me mënyrat e identifikimit të rasteve të konfliktit të interesit dhe mënyrat si mund të eliminohen ose mbahen në kontroll dhe bëhen të ditura raste të tilla dhe politikat për tregtimin ose kryerjen e transaksioneve me palët e lidhura;
- b) Përshkrimin e procedurave që do të zbatohen për të garantuar zbatimin e të gjitha kërkesave rregullatore, me qëllim mbrojtjen e interesave të investitorëve dhe ruajtjen e integritetit të tregut;
- c) Procedura lidhur me njohjen, kategorizimin, përshtatshmërinë dhe marrëdhëniet me klientin;
- d) Procedura/rregulla për marrjen dhe zbatimin e urdhrave të klientëve si dhe kryerjen e ekzekutimit më të mirë;
- e) Masat për veçimin dhe identifikimin e mjeteve të klientëve;
- f) Kontrata tip me klientin;
- g) Procedura për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave, përfshirë të gjitha shërbimet dhe transaksionet e ndërmarra;
- h) Procedura për trajtimin dhe zgjidhjen në kohë të çdo mosmarrëveshjeje dhe ankese të bërë nga klientët;
- i) Procedura/rregulla mbi mbajtjen e regjistrave të veprimeve/transaksioneve, përditësimin dhe ruajtjen e regjistrave si dhe çdo kërkesë tjetër ligjore të lidhur me regjistrimet e veprimtarisë së kryer;
- j) Procedura të raportimit tek investitorët.

4. Informacion për sistemin e kontrollit të brendshëm, si dhe informacion për procedurat operacionale.

5. Procedura në përputhje me kërkesat e raportimit në Autoritet.
6. Procedurat mbi përputhshmërinë me legjislacionin për parandalimin e pastrimit të parave.
7. Dokument që vërteton shlyerjen e pagesave ndaj Autoritetit.

Neni 9/1

Dokumentacioni shtesë për ofrimin e shërbimeve të investimit online

1. Shoqëria komisionere që kërkon të ofrojë shërbime investimi online, shoqëron njoftimin në Autoritet me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Vendim i organit drejtues të shoqërisë për ofrimin e shërbimeve online;
 - b) Përshkrim i detajuar i modelit të biznesit që do zhvillojë shoqëria;
 - c) Marrëveshje e nënshkruar me shoqërinë që ofron sistemin/programin kompjuterik për realizimin e shërbimit;
 - d) Evidencë për efektivitetin dhe sigurinë e sistemit;
 - e) Dokument që vërteton njohuritë dhe eksperiencën e personelit kyç në shërbimet e investimit online;
 - f) Procedurë e funksionimit të shërbimit të investimit online, përfshirë mekanizmat e sistemit të kontrollit të brendshëm,
 - g) Procedurë e klerimit dhe shlyerjes së transaksioneve online;
 - h) Procedurë e ruajtjes dhe administrimit të aseteve të klientit të rezultuara nga shërbimi online;
 - i) Kontratë-tip me klientin.
2. Kërkesat e këtij neni janë të zbatueshme edhe për bankat.

Neni 10

Dokumentacioni për administratorin, anëtarin e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe funksionarin kryesor

Dokumentacioni mbi administratorin, anëtarin e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe funksionarin kryesor është si më poshtë:

1. Dokument identifikimi (ID/ pasaportë).
2. Curriculum Vitae, ku të detajohet përvoja profesionale.
3. Diploma, kualifikime, trajnime dhe dokumente të tjera me rëndësi që vërtetojnë arritjet akademike dhe profesionale.

4. Dokument i lëshuar nga administrata tatimore për gjendjen e detyrimeve tatimore.
5. Vërtetim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë për gjendjen e kredive në sistemin bankar.
6. Dokumentacion të lëshuar nga organet kompetente, si më poshtë:
 - a) Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
 - b) Vërtetim nga prokuroria për hetim penal në proces;
 - c) Vërtetim nga gjykata për çështje gjyqësore në proces;
 - d) Dokument lidhur me procese ekzekutimi të detyrueshëm apo për detyrime pasurore të pashlyera.
7. Deklaratë personale se:
 - a) Nuk është përfshirë, ka bashkëpunuar ose është i lidhur me humbje financiare, të shkaktuara nga veprimet e pandershme, të papërgjegjshme apo neglizhente, në lidhje me kryerjen e shërbimeve financiare dhe administrimin e shoqërive të tjera; ose
 - b) Nuk ka zotëruar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, të paktën 50% të të drejtave të votës apo të kapitalit të një shoqërie tregtare, ose ka qenë administrator i një shoqërie tregtare, e cila është bërë objekt i procedurave të falimentimit, në zbatim të ligjit për falimentimin;
 - c) Nuk është përfshirë në ndonjë praktikë tregtare, përfshirë edhe evazionin fiskal dhe pastrimin e parave, që Autoriteti e konsideron të papërshtatshme, qoftë e ligjshme ose jo, e cila hedh dyshime për mënyrën e kryerjes së shërbimeve financiare apo të veprimtarive të tjera tregtare nga ky person.
8. Deklaratë personale për lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë sipas seksionit 3 të shtojcës 1.
9. Për funksionarin kryesor, përveç sa më sipër, depozitohet dhe dokumenti që vërteton certifikimin nga shoqëria në përputhje me kërkesat e Ligjit dhe rregullores në fuqi.

Neni 11

Kriteri profesional për administratorin, anëtarin e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës

1. Administratori, anëtari i këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës duhet të plotësojë kërkesën për përvojë profesionale minimumi prej 3(tre) vitesh, me kohë të plotë në një prej funksioneve si më poshtë:
 - a) Funksione administruese/drejtuese dhe kontrolli në shoqëri tregtare në fushën financiare dhe shërbime të lidhura me to;

- b) Aktivitete profesionale të lidhura drejtpërdrejtë me sektorin bankar, financiar, apo funksione të tjera të lidhura me aktivitetin kryesor të tregjeve të kapitalit, фондеве të investimit/pensioneve;
 - c) Përvojë akademike në ekonomi dhe/ose drejtësi;
 - d) Funksione drejtuese në ente publike, administratë publike dhe/ose institucione të pavaruara publike, të lidhura me sektorin financiar dhe/ose bankar.
2. Kryetari i këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës plotëson kriterin e mësipërm për një periudhë minimalisht prej 5 vitesh.
 3. Personat e përmendur sipas pikës 1, duhet të zotërojnë diplomë të arsimit të lartë minimalisht të nivelit “Master Profesional” ose të barasvlershme.

KREU III

LICENCIMI I BANKËS PËR TË OFRUAR SHËRBIME INVESTIMI NË TITUJ

Neni 12

Dokumentacioni që shoqëron kërkesën për licencim të bankës

1. Bankat, të cilat janë licencuar nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtaritë financiare të parashikuara nga ligji në fuqi “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, mund të ofrojnë shërbime investimi në tituj vetëm pasi të jenë licencuar nga Autoriteti për të ushtruar këtë veprimtari.
2. Veprimtaritë financiare të përcaktuara në Ligjin për Bankat janë ekuivalente me shërbimet e investimit të përcaktuara në Ligjin për Tregjet e Kapitalit, sipas shtojcës 3 të kësaj rregulloreje.
3. Kërkesa për licencimin e bankës për të ofruar shërbime investimi në tituj bëhet sipas shtojcës 2, bashkëngjitur kësaj rregulloreje, së bashku me dokumentacionin e kërkuar nga ligji dhe kjo rregullore si më poshtë:
 - I. Dokumentacioni mbi strukturën ose njësinë përgjegjëse
 - a) Licencën për ushtrim veprimtarie si bankë, lëshuar nga Banka e Shqipërisë, së bashku me aneksin shoqërues, ku të jetë përfshirë edhe veprimtaria për të cilën kërkohet licenca;
 - b) Vendimin e organit kompetent të bankës për të ofruar shërbime investimi në tituj;

- c) Strukturën organizative të njësisë përgjegjëse për kryerjen e shërbimeve të investimit, ku parashikohet ndarja e veprimtarisë së investimeve në tituj nga pjesa tjetër e aktiviteteve me të cilat është angazhuar banka;
- d) Përshkrimin e çdo pozicioni brenda strukturës dhe përgjegjësitë e personelit kyç, ku përfshihen edhe:
 - i. Curriculum Vitae të personelit kyç;
 - ii. Deklaratë mbi vërtetësinë e informacionit të përmendur në Curriculum Vitae;
 - iii. Dokumenti i certifikimit të personelit kyç mbi aftësinë dhe përshtatshmërinë për kryerjen e shërbimeve të investimit.

II. Dokumentacioni mbi organizimin e veprimtarisë së shërbimit në investime

- a) Dokument ku parashikohet një përshkrim mbi sistemin e teknologjisë së informacionit për kryerjen e veprimtarisë për të cilën kërkohet licencë;
- b) Procedura lidhur me njohjen, kategorizimin, përshtatshmërinë dhe marrëdhëniet me klientin;
- c) Masat për veçimin dhe identifikimin e mjeteve të klientëve;
- d) Kontrata tip me klientin;
- e) Procedura për trajtimin dhe zgjidhjen në kohë të çdo mosmarrëveshjeje dhe ankesave të klientit;
- f) Procedura/rregulla për marrjen dhe zbatimin e urdhrave të klientëve si dhe kryerjen e ekzekutimit më të mirë;
- g) Procedura/rregulla mbi mbajtjen e regjistrave të veprimeve/transaksioneve, përditësimin dhe ruajtjen e regjistrave si dhe çdo kërkesë tjetër ligjore të lidhur me regjistrimet e veprimtarisë së kryer;
- h) Procedura të raportimit tek klientët.

4. Dokument që vërteton shlyerjen e pagesave ndaj Autoritetit.

KREU IV

REGJISTRIMI I DEGËS DHE NJOHJA E SHOQËRISË SË HUAJ KOMISIONERE

Neni 13

Dokumentacioni për regjistrimin e degës ose zyrës së përfaqësimit

1. Shoqëria e huaj komisionere, që kërkon të ushtrojë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet regjistrimit të një degë ose zyre përfaqësimi, njofton paraprakisht Autoritetin.

2. Kërkesa për regjistrimin e degës ose zyrës së përfaqësimit shoqërohet me dokumentacionin, si më poshtë:

I. Dokumentacioni mbi degën ose zyrën e përfaqësimit

- a) Kërkesa e shoqërisë së huaj komisionere e firmosur nga përfaqësuesi ligjor për të regjistruar degën ose zyrën e përfaqësimit, ku të specifikohet lloji i shërbimeve në investime në tituj për të cilin subjekti kërkon regjistrim;
- b) Vendimi i organit kompetent të shoqërisë së huaj për të regjistruar degë/zyrë përfaqësimi në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- c) Ekstrakti i regjistrimit në QKB;
- d) Adresa në Republikën e Shqipërisë në të cilën mund të merren dhe dërgohen dokumente;
- e) Kopje apo të dhëna të licencës që ka marrë subjekti nga autoriteti kompetent i vendit të tij, ku të specifikohet lloji i shërbimeve në investime në tituj për të cilin është licencuar;
- f) Informacion mbi njoftimin e autoritetit rregullator të vendit të origjinës për kryerjen e veprimtarisë së kërkuar.

II. Dokumentacioni mbi organizimin e veprimtarisë së shërbimit në investime

- a) Informacion mbi strukturën organizative të degës ose zyrës së përfaqësimit, përfshirë informacionin nëse dega synon të përdorë agjentë të lidhur dhe identitetin e këtyre agjentëve të lidhur;
- b) Programin e veprimtarive, ku përshkruhen shërbimet e investimit ose shërbime të tjera që propozon të ofrojë në Republikën e Shqipërisë;
- c) Dokument ku parashikohet një përshkrim mbi sistemin e teknologjisë së informacionit për kryerjen e veprimtarisë;
- d) Emrat e funksionarëve kryesorë të cilët janë përgjegjës për administrimin e degës/zyrës së përfaqësimit;
- e) Informacion mbi funksionarët kryesorë, brokerin/këshilltarin e investimeve/administratorin e portofolit, të cilët janë certifikuar apo do të certifikohen nga shoqëria në përputhje me kërkesat e Ligjit dhe rregullores në fuqi.

III. Procedurat e brendshme që rregullojnë:

- a) Njohjen, kategorizimin, përshtatshmërinë dhe marrëdhëniet me klientin;
- b) Masat për veçimin dhe identifikimin e mjeteve të klientëve;
- c) Kontrata tip me klientin;
- d) Trajtimin dhe zgjidhjen në kohë të çdo mosmarrëveshjeje dhe ankesave të klientit;
- e) Marrjen dhe zbatimin e urdhrave të klientëve si dhe kryerjen e ekzekutimit më të mirë;

- f) Mbajtjen e regjistrave të veprimeve/transaksioneve, përditësimin dhe ruajtjen e regjistrave si dhe çdo kërkesë tjetër ligjore të lidhur me regjistrimet e veprimtarisë së kryer;
 - g) Procedura të raportimit tek klientët.
3. Dokument që vërteton shlyerjen e pagesave ndaj Autoritetit.

Neni 14

Dokumentacioni për njohjen e personit të licencuar në një vend të huaj

1. Personi juridik i huaj, i licencuar nga një autoritet i huaj rregullator mund të ushtrojë veprimtari investimesh në tituj në Republikën e Shqipërisë, duke përdorur një agjent të lidhur, vetëm pas njohjes së licencës nga Autoriteti.
2. Personi juridik i huaj, i cili kërkon të njihet për të ofruar shërbime investimi në tituj, depoziton dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kërkesën për njohjen e licencës së dhënë nga autoriteti i huaj, për ofrimin e shërbimeve të investimit në tituj, të firmosur nga përfaqësuesi ligjor i personit të huaj;
 - b) Kopje ose të dhëna të licencës, ku të specifikohet lloji i shërbimeve në investime në tituj për të cilin është lëshuar licenca;
 - c) Vendimin e organit kompetent të shoqërisë në vendin e origjinës për të ushtruar shërbime investimesh në tituj, në territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - d) Vendndodhjen e selisë qendrore;
 - e) Informacion mbi njohimin e autoritetit rregullator të vendit të origjinës për kryerjen e veprimtarisë së kërkuar;
 - f) Identitetin e agjentëve të lidhur me anë të të cilëve subjekti kërkues do të ushtrojë veprimtari;
 - g) Një përshkrim të shërbimeve të synuara që do të ofrohen nga agjentët e lidhur dhe strukturën organizative, përfshirë linjat e raportimit, dhe informacion për mënyrën se si shoqëria e huaj komisionere do të sigurojë përputhshmërinë me aktet ligjore dhe nënligjore të Republikës së Shqipërisë;
 - h) Deklaratë se anëtarët e organeve drejtuese, funksionarët kryesorë dhe personat që ushtrojnë kontroll mbi subjektin kërkues plotësojnë kriteret e aftësisë dhe të përshtatshmërisë;
 - i) Dokument që të vërtetojë ekzistencën e rregullave ekuivalente në legjislacionin e vendit të origjinës të kërkuesit me legjislacionin e aplikuar në Republikën e Shqipërisë;
 - j) Vetëdeklarim i nënshkruar nga organi kompetent i subjektit kërkues ose përfaqësuesi i tij ligjor se subjekti në fjalë do të veprojë në përputhje me standardet dhe parimet

ndërkombëtare, do të respektojë etikën profesionale e do t'u ofrojë investitorëve në Republikën e Shqipërisë trajtim të barabartë.

3. Gjatë procesit të njohjes së subjektit kërkues për kryerjen e veprimtarisë së investimit në tituj, Autoriteti bashkëpunon dhe shkëmben informacion me autoritetin e huaj përkatës.
4. Dokument që vërteton shlyerjen e pagesave ndaj Autoritetit.

Neni 15

Njoftimi për regjistrimin e degës/zyrës së përfaqësimit dhe njohjen e personit juridik të huaj nga Autoriteti

1. Autoriteti brenda 3 (tre) muajve nga marrja e informacionit të plotë për regjistrimin e degës/zyrës së përfaqësimit njofton subjektin kërkues, autoritetin rregullator të vendit të origjinës si dhe shoqërinë e huaj komisionere për regjistrimin. Në vendimin e regjistrimit Autoriteti specifikon veprimtarinë përkatëse për të cilën regjistrohet dega ose zyra e përfaqësimit.
2. Përveç kërkesave të parashikuara në Ligj dhe në këtë rregullore Autoriteti në regjistrimin e një dege ose zyre përfaqësimi vlerëson gjithashtu nëse:
 - a) Është vendosur bashkëpunim i kënaqshëm mbikëqyrës ndërmjet autoritetit rregullator të vendit të origjinës të shoqërisë komisionere dhe Autoritetit;
 - b) Shoqëria komisionere është objekt i mbikëqyrjes së përshtatshme në vendin e origjinës;
 - c) Shoqëria komisionere përmbush kërkesat e vendosura për ushtrimin e veprimtarisë tregtare në vendin e origjinës dhe këto kërkesa u sigurojnë investitorëve në Republikën e Shqipërisë mbrojtje të paktën ekuivalente me atë që u jepet kur investojnë pranë shoqërive vendase komisionere.
3. Autoriteti brenda 3 (tre) muajve nga marrja e informacionit të plotë për njohjen e personit juridik të huaj njofton autoritetin rregullator të vendit të origjinës dhe shoqërinë e huaj komisionere mbi njohjen e veprimtarisë për të kryer shërbime investime në tituj duke specifikuar veprimtarinë përkatëse për të cilën jepet njohja.
4. Autoriteti regjistron në regjistrin përkatës çdo subjekt për të cilin është dhënë regjistrimi apo njohja për të ushtruar shërbime investimi në tituj.

KREU V MIRATIMI I NDRYSHIMEVE

Neni 16
Ndryshimet që kërkojnë miratim

1. Autoriteti miraton çdo ndryshim të shoqërisë komisionere në lidhje me:
 - a) Ndryshimin e veprimtarisë tregtare;
 - b) Ndryshimin e zotëruesve të pjesëmarrjes influencuese;
 - c) Ndryshimin e administratorit, anëtarëve të këshillit administrues / këshillit mbikëqyrës, funksionarëve kryesorë;
2. Pika 1/a e këtij neni zbatohet edhe për bankat e licencuara nga Autoriteti për të kryer shërbime investimi.

Neni 17
Kërkesa dhe dokumentacioni për ndryshime të veprimtarisë tregtare

1. Shoqëria komisionere njofton paraprakisht Autoritetin për ndryshime në:
 - a) Veprimtarinë tregtare dhe mënyrën e ushtrimit të saj;
 - b) Ndërprejjen e kryerjes së një apo disa shërbimeve të investimit për të cilat është licencuar;
 - c) Llojin e instrumenteve financiare;
 - d) Bazën e synuar të klientëve;
 - e) Ofrimin e shërbimeve të investimit online.
2. Njoftimi për ndryshimet e mësipërme shoqërohet me kërkesën përkatëse sipas seksioneve 1, 2 dhe 6, të shtojcës 1 bashkëngjitur kësaj rregulloreje, si dhe depoziton dokumentacionin e përditësuar të përcaktuar në nenin 7 dhe 9, të kësaj rregulloreje, për të vërtetuar përshtatjen me ndryshimet e kërkuara.

Neni 18
Kërkesa dhe dokumentacioni për ndryshime të zotëruesve të pjesëmarrjes influencuese

1. Personi fizik ose juridik që kërkon të zotërojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, pjesëmarrje influencuese ose kërkon të rrisë, shesë ose zvogëlojë zotërimin e pjesëmarrjes influencuese në një shoqëri komisionere, njofton paraprakisht me shkrim Autoritetin për qëllimin e tij.
2. Personat që kërkojnë të bëhen zotërues të pjesëmarrjes influencuese duhet të depozitojnë kërkesë sipas seksionit 1, 3 dhe 4 të shtojcës 1 dhe dokumentacionin e përcaktuar në nenin 8 të kësaj rregulloreje.

3. Autoriteti, në rastet e ndryshimit të zotëruesve të pjesëmarrjes influencuese, vlerëson përshtatshmërinë e blerësit të propozuar duke marrë në konsideratë edhe kriteret sa më poshtë:
 - a) Blerësi i propozuar të jetë i aftë dhe i përshtatshëm për këtë qëllim në përputhje me kërkesat e Ligjit dhe kësaj rregulloreje;
 - b) Ndryshimi i pjesëmarrjes nuk rrezikon interesat e investitorëve.

Neni 19

Kërkesa dhe dokumentacioni për ndryshimin e administratorit, anëtarit të këshillit të administrimit/ këshillit mbikëqyrës dhe funksionarit kryesor

1. Shoqëria komisionere duhet të njoftojë paraprakisht Autoritetin për çdo ndryshim të administratorit, anëtarëve të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe funksionarit kryesor.
2. Për çdo person që do të emërohet si administrator, anëtar i këshillit të administrimit/ këshillit mbikëqyrës, shoqëria duhet të depozitojë kërkesë sipas seksionit 1 dhe 5 të shtojcës 1, si dhe dokumentacionin e përcaktuar në nenin 10 dhe 11 të kësaj rregulloreje.
3. Për çdo person që do të emërohet si funksionar kryesor, shoqëria duhet të depozitojë kërkesën dhe dokumentin e certifikimit, si dhe informacionin mbështetës mbi mënyrën e certifikimit.
4. Njoftimi dhe dokumentacioni përkatës depozitohen në Autoritet 3 muaj para bërjes efektive të ndryshimeve.
5. Përjashtim nga pika 4 e këtij neni bën ndryshimi në rrethana jo të zakonshme. Në këtë rast do të zbatohet procedura sipas nenit 37, pika 2,3 dhe 4 e Ligjit.

Neni 20

Riemërimi i administratorit, anëtarit të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës të shoqërisë komisionere dhe funksionarit kryesor

1. Shoqëria komisionere njofton Autoritetin brenda 10 ditëve nga përfundimi i mandatit të administratorit/ anëtarit të këshillit të administrimit/ këshillit mbikëqyrës dhe funksionarit kryesor.

2. Për çdo ndryshim të të dhënave, mbi bazën e të cilave është vlerësuar dhe miratuar administratori, anëtari i këshillit të administrimit/ këshillit mbikëqyrjes dhe funksionari kryesor, shoqëria komisionere njofton me shkrim Autoritetin, brenda 10 ditëve nga ndryshimi i këtyre të dhënave.
3. Për çdo person që do të riemërohet si administrator, anëtar i këshillit të administrimit/ këshillit mbikëqyrës ose funksionar kryesor, shoqëria komisionere duhet të depozitojë vendimin e organit kompetent për riemërimin, shoqëruar me një CV të përditësuar sipas formatit të aneksit 1 të shtojcës 1 të kësaj rregulloreje brenda 5 ditë pune. Në rastin e funksionarit kryesor, shoqëria depoziton çdo vit informacion mbi ricertifikimin.

KREU VI

PROCEDURA PËR LICENCIM, REGJISTRIM, NJOHJE DHE MIRATIM TË NDRYSHIMEVE

Neni 21

Afati i trajtimit të kërkesave

1. Autoriteti, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës, shqyrton kërkesën dhe listën e dokumenteve të depozituara për licencim/regjistrim/njohje/miratim të ndryshimeve sipas Ligjit dhe kësaj rregulloreje.
2. Autoriteti, nëse vëren se kërkesa e dorëzuar nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar, i kërkon subjektit me shkrim ose në mënyrë elektronike, që brenda 10 (dhjetë) ditëve pune të plotësojë kërkesën duke specifikuar dokumentet që mungojnë.
3. Nëse subjekti për arsye të argumentuara nuk është në gjendje të paraqesë ndonjë nga dokumentet brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve pune, Autoriteti kur e shikon të arsyeshme mund të zgjasë afatin edhe me 10 (dhjetë) ditë pune të tjera. Nëse subjekti kërkues nuk dorëzon dokumentet e kërkuara brenda afatit të përcaktuar në këtë nen, Autoriteti refuzon kërkesën si të pa plotë dhe njofton subjektin kërkues për refuzimin e kërkesës, duke dhënë argumentet përkatëse.

Neni 22

Shqyrtimi i dokumentacionit

1. Gjatë periudhës së shqyrtimit, Autoriteti mund të kërkojë çdo informacion të mëtejshëm që është i nevojshëm për të gjykuar mbi plotësimin e kriterëve nga subjekti kërkues. Kërkesa

për plotësim dokumentacioni dhe/ose përmirësim i përmbajtjes së dokumenteve të depozituara, i komunikohet subjektit me shkrim ose në mënyrë elektronike.

2. Gjatë periudhës së shqyrtimit, Autoriteti vlerëson:
 - a) përmbushjen e kritereve për përshtatshmëri dhe aftësi të aksionarëve, administratorit dhe anëtarëve të këshillit të administrimit / këshillit mbikëqyrës, si dhe funksionarëve kryesorë sipas kërkesave të Ligjit dhe të kësaj rregulloreje;
 - b) përputhshmërinë e subjektit kërkues me kërkesat e Ligjit dhe të kësaj rregulloreje;
 - c) aftësinë e subjektit kërkues për të ruajtur dhe plotësuar në të ardhmen kushtet e licencimit/regjistrimit/njohjes.
3. Gjatë periudhës së shqyrtimit, Autoriteti mban parasysh madhësinë e subjektit kërkues, llojet e shërbimeve të investimit dhe instrumentet financiarë ku synohet të operohet, rreziqet me të cilat do të përballet subjekti.

Neni 23 **Marrja e vendimit**

1. Autoriteti merr vendim për licencim/regjistrim/njohje apo miratim të ndryshimeve brenda 3 (tre) muajve nga plotësimi i kërkesave të Ligjit dhe të kësaj rregulloreje.
 2. Në vendimin për licencim të shoqërisë komisionere, Autoriteti përfshin vendimin për miratimin e:
 - a) Zotëruesit të pjesëmarrjes influencuese;
 - b) Emërimit të administratorit, anëtarit të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe funksionarëve kryesorë.
- 2/1. Në rastin e ofrimit të shërbimit të investimit online nga shoqëria komisionere/banka, Autoriteti pas vlerësimit të dokumentacionit sipas nenit 9/1 të kësaj rregulloreje, i jep shoqërisë komisionere/bankës të drejtën për kryerjen e shërbimeve të investimit online.
3. Autoriteti refuzon kërkesën për licencim/regjistrim/njohje apo miratim nëse nuk plotësohen kërkesat e Ligjit dhe të kësaj rregulloreje.

Neni 24 **Dispozitë kalimtare**

1. Shoqëritë komisionere dhe bankat e licencuara në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9879 datë 21.2.2008 “Për titujt” vijojnë veprimtarinë në përputhje me licencën përkatëse.
2. Shoqëritë komisionere dhe bankat e licencuara duhet të depozitojnë në Autoritet një raport të detajuar të përshtatshmërisë me kërkesat e Ligjit 62/2020 dhe rregulloreve të dala në zbatim të tij, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
3. Raporti i përshtatshmërisë depozitohet në Autoritet, jo më vonë se 3 muaj përpara përfundimit të afatit të përcaktuar në ligj.
4. Autoriteti shqyrton raportin e përshtatshmërisë dhe dokumentacionin e depozituar, dhe shprehet me vendim mbi përshtatshmërinë.
5. Licencat e lëshuara përpara hyrjes në fuqi të ligjit 62/2020, brenda 1 (një) muaji pas vendimit mbi përshtatshmërinë, i nënshtrohen riformatimit në përputhje me kërkesat e ligjit dhe të kësaj rregulloreje.
6. Nëse shoqëria komisionere / banka nuk përshtatet sipas kërkesave të ligjit dhe rregulloreve në zbatim të tij, brenda afatit të përcaktuar në ligj, do të zbatohen masat mbikëqyrëse.
7. Kërkesat për zgjerimin e licencës apo ndryshimin e veprimtarisë tregtare për shoqëritë komisionere dhe bankat e licencuara si shoqëri komisionere në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9879 datë 21.2.2008 “Për titujt”, do të shqyrtohen nga Autoriteti, në një linjë me shqyrtimin e përshtatshmërisë.

Neni 25

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

SHTOJCA 1

FORMË KËRKESA PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË KOMISIONERE

Seksioni 1

Informacioni për subjektin kërkues

Informacioni i kërkuar	Plotësoni informacionin
Emri i shoqërisë komisionere	
Adresa e selisë së shoqërisë komisionere	
Adresa e degëve të tjera të shoqërisë komisionere për ushtrimin e veprimtarisë e ndryshme nga selia qendrore (nëse ka)	
Emri i personit të autorizuar	
Pozicioni i punës së personit të autorizuar	
Adresa e <i>e-mail</i> të personit të autorizuar	
Numri i telefonit të personit të autorizuar	
Adresa e faqes zyrtare të internetit, nëse është e aplikueshme	

Seksioni 2

Statusi i subjektit

2.1 Statusi

Informacioni i kërkuar	Plotësoni informacionin
Numri i identifikimit të shoqërisë komisionere (NUIS)	

Bashkëngjitni Certifikatën e regjistrimit

2.2 Veprimtaritë për të cilat shoqëria komisionere kërkon të licencohet

Zgjidhni veprimtaritë që do të kryhen nga shoqëria komisionere, listuar si më poshtë. Vendosni X në kutinë përkatëse

Veprimtaritë:	
1. Marrja dhe transmetimi i urdhrave për një ose më shumë instrumente financiare.	
2. Ekzekutimi i urdhrave për llogari të klientëve.	
3. Tregtimi për llogari të vet.	
4. Administrimi i portofolit.	
5. Veprimtaria e këshillimit për investime.	
6. Nënshkrimi i instrumenteve financiare dhe/ose hedhja në treg e instrumenteve financiare me angazhim shitjeje.	
7. Hedhja në treg e instrumenteve financiare pa angazhim shitjeje.	
8. Operimi i një platforme shumëpalëshe tregtimi.	
9. Operimi i një platforme të organizuar tregtimi.	
Shërbime ndihmëse:	
a) ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve;	
b) dhënia e kredive ose e huave një investitori për t'i dhënë mundësi të kryejë një transaksion me një ose më shumë instrumente financiare, ku shoqëria që jep kredinë ose huanë, ose një subjekt tjetër i lidhur me të, është e përfshirë në transaksion;	
c) këshillimi i shoqërive tregtare në lidhje me strukturën e kapitalit, strategjinë industriale dhe çështjet e lidhura me to, këshillimi e ofrimi i shërbimeve për bashkimin dhe blerjen e shoqërive tregtare;	
ç) shërbimet e këmbimit valutor kur këto janë të lidhura me ofrimin e shërbimeve të investimit në tituj;	
d) identifikimi i investimeve dhe kryerja e analizave financiare lidhur me to ose ofrimi i formave të tjera të rekomandimeve të përgjithshme në lidhje me transaksionet me instrumente financiare;	
dh) shërbimet e lidhura me dhënie të angazhimeve për blerjen e titujve;	
e) shërbimet dhe veprimtaritë e investimit në tituj, si edhe shërbimet ndihmëse të lidhura me instrumentet derivative kur këto janë të lidhura me ofrimin e shërbimeve të investimit në tituj ose shërbimeve të tjera ndihmëse.	

Instrumentet financiare:	
a) titujt e transferueshëm;	
b) instrumentet e tregut të parasë;	
c) kuotat e sipërmarrjeve të investimeve kolektive;	
ç) kontratat e opsioneve (<i>options</i>), kontratat e së ardhmes (<i>futures</i>), marrëveshjet e shkëmbimit (<i>swap</i>), kontratat që paracaktojnë normën e interesit në të ardhmen dhe çdo kontratë tjetër derivative lidhur me tituj, monedha, norma interesi ose kthimi (<i>yields</i>), kuotat e lejuara për çlirimin e gazeve serrë ose instrumente të tjera derivative, indekse financiare ose njësi financiare, të cilat mund të shlyhen fizikisht ose me para;	
d) kontratat e opsioneve (<i>options</i>), kontratat e së ardhmes (<i>futures</i>), marrëveshjet e shkëmbimit (<i>swap</i>), kontratat e shitjes në të ardhmen me çmim të paracaktuar (<i>forwards</i>) dhe çdo kontratë tjetër derivative në lidhje me mallra (<i>commodities</i>) që duhet të shlyhen në para ose që mund të shlyhen në para me zgjedhjen e njëjës prej palëve, duke përjashtuar rastet e zgjidhjes së kontratës për mospërbushje ose për ndonjë arsye tjetër;	
dh) kontratat e opsioneve (<i>options</i>), kontratat e së ardhmes (<i>futures</i>), marrëveshjet e shkëmbimit (<i>swap</i>) dhe kontrata të tjera derivative në lidhje me mallra (<i>commodities</i>), që mund të shlyhen fizikisht me kusht që të tregtohen në një treg të rregulluar, në një platformë shumëpalëshe tregtimi, ose në një platformë të organizuar tregtimi, me përjashtim të produkteve energjetike të tregtuara me shumicë në një platformë të organizuar tregtimi, të cilat duhet të shlyhen fizikisht;	
e) kontratat e opsioneve (<i>options</i>), kontratat e së ardhmes (<i>futures</i>), marrëveshjet e shkëmbimit (<i>swap</i>) dhe kontrata të tjera derivative në lidhje me mallra (<i>commodities</i>), që mund të shlyhen fizikisht e që nuk janë përmendur në shkronjën “dh” më sipër, të cilat nuk mbahen për qëllime tregtare, por kanë karakteristikat e instrumenteve të tjera financiare derivative;	
ë) instrumentet derivative për transferimin e riskut të kredisë;	
f) kontratat financiare për diferencë;	
g) kontratat e opsioneve (<i>options</i>), kontratat e së ardhmes (<i>futures</i>), marrëveshjet e shkëmbimit (<i>swap</i>), kontratat që paracaktojnë normën e interesit në të ardhmen dhe çdo kontratë tjetër derivative në lidhje me variablat klimaterike, çmimet e transportit të mallrave ose normat e inflacionit, ose statistika të tjera ekonomike zyrtare, e cila duhet të shlyhet me para ose mund të shlyhet me para me zgjedhjen e njëjës prej palëve, duke përjashtuar rastin e zgjidhjes së kontratës për mospërbushje apo ngjarje tjetër, si edhe çdo kontratë tjetër derivative në lidhje me aktive, të drejta, detyrime, indekse dhe masa që nuk përmenden më sipër, e cila ka karakteristikat e instrumenteve të tjera financiare derivative, duke mbajtur parasysh, ndër të tjera, nëse tregtohen në një treg të rregulluar, platformë të organizuar tregtimi ose platformë shumëpalëshe tregtimi.	

2.3 Statuti i shoqërisë komisionere

Bashkëngjitni statutin/aktin e themelimit të shoqërisë komisionere, ku objekti i veprimtarisë dhe kapitali minimal fillestar, të përputhet me veprimtarinë për të cilat subjekti kërkon të licencohet si dhe të përshkruhet roli i anëtarëve të pavarur të këshillit të administrimit, shoqëruar me një përshkrim të detyrave dhe përgjegjësive të tyre.

Seksioni 3

Pronësia e subjektit kërkues

3.1 Zotëruesit e subjektit

Listoni të gjithë aksionarët e subjektit: personat fizikë sipas 3.1.1 dhe personat juridikë sipas 3.1.2

3.1.1 Aksionarin Personat fizikë/individë

Emri/Mbiemri i aksionarit Person fizik	Shtetësia e aksionarit	Numri personal i identifikimit/ Numri pasaportës për shtetasit e huaj	Numri i aksioneve të emetuara	Vlera e aksioneve	Përqindja e zotëruar

Bashkëngjitni aplikimit sa më poshtë:

Një kopje të kartës së identitetit (ose një kopje të pasaportës për shtetasit e huaj) për çdo CV;

Curriculum Vitae dhe vetëdeklarim për çdo person fizik i cili është aksionar. Curriculum Vitae dhe vetëdeklarimi për çdo person duhet të plotësohen sipas formatit të paraqitur në Aneksin e kësaj Shtojce;

Dëshmi të burimeve të krijimit të kapitalit si blerje ose shitje, dhurata, paga, depozita monetare në banka dhe/ose degë të bankave të huaja apo dëshmi të tjera për burimin e krijimit të kapitalit;

Dokument të lëshuar nga administrata tatimore mbi gjendjen e detyrimeve tatimore;

Vërtetim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë për gjendjen e kredive në sistemin bankar;

Dokumentacion të lëshuar nga organet kompetente, si më poshtë:

- *Vërtetim i gjendjes gjyqësore;*
- *Vërtetim nga prokuroria për hetim penal në proces;*
- *Vërtetim nga gjykata për çështje gjyqësore në proces;*
- *Dokument lidhur me procese ekzekutimi të detyrueshëm apo për detyrime pasurore të pashlyera.*

Deklaratë personale për lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë, sipas Aneksit 3 të kësaj Shtojce.

3.1.2 Aksionarin Personat juridikë

Emri i aksionarit Person juridikë	Adresa	Numri i identifikimit (NUIS)	Objekti i aktivitetit	Numri i aksioneve të emetuara	Vlera e aksioneve	Përqindja e zotëruar

Bashkëngjitni aplikimit sa më poshtë:

Pasqyrat financiare të audituara për 3 vitet e fundit, dhe në rastin e një shoqërie më të re, pasqyrat që nga krijimi;

Dokument të lëshuar nga administrata tatimore mbi gjendjen e detyrimeve tatimore;

Vërtetim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë për gjendjen e kredisë në sistemin bankar;

Deklaratë se shoqëria nuk është nën hetim dhe/ose proces gjyqësor për kryerjen e ndonjë vepre penale;

Dokument se shoqëria nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera;

